



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 26

Datë: 08. 06. 2020. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikalo, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.21 dhe 22/2020.

2. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të Sekretariatit të KQZ-së për periudhën janar-mars 2020.

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Suharekë.
- Shqyrtim i kërkesave për shtyrje të Kuvendeve të Partive Politike: Organizata e Ballit Kombëtar të Kosovës, Balli Kombëtar i Kosovës, Gradanska Iniciativa Gore, Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës dhe NISMA Socialdemokrate;

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të rishikuar të auditimit të brendshëm për vitin 2020.

4. Të ndryshme.

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: E hapi mbledhjen e 26-të... A ka vërejtje në rend dite...? Nëse jo, kush është për...?

Anëtarët e KQZ miratuan rendin e ditës me vota unanime, si dhe shqyrtuan dhe miratuan procesverbalet nga mbledhjet e KQZ, nr: 21, 22 dhe 23/2020.

2.Raporti i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të Sekretariatit të KQZ-së për periudhën janar-mars 2020

Alim Rama: Këshilli, ka shqyrtuar raportin e Sekretariatit për periudhën janar-mars 2020...Para se me e marrë fjalën krye shefi, kisha dhënë një sugjerim që kur raporti dorëzohet në këshill, të dërgohet së paku 2 – 3 ditë përpara në mënyrë që me pas kohë me e trajtuar dhe me dhanë rekomandime. Ne këtë raport e kemi trajtuar, kemi dhënë disa rekomandime, por disa tjera nuk kemi pasur kohë me i dhënë...Sekretariati i ka inkorporuar, dhe në parim këshilli rekomandon për aprovim...

Yll Buleshkaj: Ne, jemi munduar që ta paraqesim gjendjen reale, ato detyra që kemi mundur ti zbatojmë në këto rrethana dhe që kanë qenë në plan të punës...dhe disa aktivitete të rëndësishme, por që nuk kanë qenë në plan të punës...Në të ardhmen, do të përpiqemi që raportet t'i kenë edhe të dhënat financiare...

Mendoj që raporti pasqyron një gjendje reale...

Alim Rama: Po jap disa komente, sepse janë disa aktivitete që janë paraqitur që nuk janë në detale, dhe unë kisha thënë se të gjitha rekrutimet, punësimet që bëhen të jenë publike, të paraqiten në institucionet përkatëse...Kjo e rritë transparencën, e largon mundësinë e manipulimeve...! Pozitat që i kemi, ato të zyrtarëve Komunal, duhet të jenë transparente, intervistimet të bëhen edhe me praninë e atyre që bëjnë monitorimet...Po ashtu, një këshillë tjetër: edhe pse ky plan është aprovuar në shkurt, herën tjetër parashikimet të jenë më reale...

Sami Kurteshi: E kam lexuar raportin, dhe nuk e kam ditur që për herë të parë të paraqitet një raport i këtillë. Ky është një dokument, dhe patjetër të bëhet lekturimi i tij. Mendoj që, pjesa më e mirë e këtyre raporteve, të futet në raportin vjetor të KQZ-së, sepse duhet t'i ofrohet opinionit, Kuvendit dhe, me të gjitha, pasqyrohet puna jonë...Sekretariati, KQZ i di më së miri ato që bëhen,

sepse e konsideroj këtë raport me rëndësi...pra, ti shohim krejt shqyrtimet, analizat...

Sami Hamiti: E kemi analizuar raportin, pra është vendos një standard i ri. Ka qenë edhe kërkesë e jona që të shohim raportin e realizimit të planit të punës...Sugjerimi im që ishte edhe në këshill, në të ardhmen raporti të jetë së bashku, edhe me raportin financiar...Pra, pjesa narrative ta ketë edhe pjesën financiare...Mandej, kemi një raport të plotë...Sugjerimi i z. Kurteshi, ishte me vend që materiali të lekturohet...Rreth rekrutimit: duhet me ju përmbajt ligjit, janë përcaktimet e sakta...Është edhe Këshilli Mbikëqyrës që, mund ta ftojme që ta monitoroj procesin...përmbajuni ligjit...

Valdete Daka: Kemi pas kërkuar kur e kemi zgjedhë drejtorin e Zyrës, kemi kërkuar që të marr pjesë ambasada britanike, dhe organizata civile por, nuk kanë qenë të interesuar...Këshillin Mbikëqyrës, e kemi obligim ta njoftojmë...

Alim Rama: Të gjitha KQZ-të në botë, e bëjnë këtë për të qenë çdo gjë transparente...

Eshref Vishi: Statusi i nëpunësve civilë, është i rregulluar me ligjin e shërbyesve civilë...asgjë nuk mund të kërkoj KQZ më shumë se sa respektimi i procedurave dhe ligjore...ne nuk mund të nxjerrin standarde tjera...

Ndërsa, sa i përket raportit, unë kam pritur nga KOZ që, të dalë me rekomandim lidhur me raportin që, edhe të na e lehtësoj ne punën...E kam lexuar raportin, madje edhe planin e punës...! Në tërësi, plani i punës nuk i ka pasur më shumë se 10 aktivitete që është dashur të përfundojnë në tremujorin e parë, prandaj, në raport është dashur me u fokusue vetëm në punën që është kryer...

Kërkesa ime, tha z. Vishi, është që në të ardhmen, gjatë raportimeve të mos kemi ngarkesë, dhe të fokusohemi vetëm në punën që është kryer...! Por, në raporte është mirë të marrim edhe rekomandime, fidbeke...është me rëndësi...Ne kemi përvojë, pothuajse secili nga ne nga institucione që vijmë...

Ibrahim Selmanaj: Është praktikë e mirë, bëhet fjalë për një periudhë tremujore që ka pasur vështirësitë e veta...! Jo vetëm me punën këtu por edhe në terren, duhet të rrisim transparencën...Do të ndalem më konkretisht te Lista Zgjedhore që është një problem që në vazhdimësi na ka nxjerrë telashe...Edukimi i Votuesve, meqë kemi numër të madh të votave të pavlefshme...!/? Duhet të rritet bashkëpunim me partitë politike, me OJQ-të, mediat...në mënyrë që të mbërrijmë deri te votuesi që të mos na paraqiten këto probleme, t'i eliminojmë sa më shumë...

Arianit Elshani: U potencua fakti që është i rëndësishëm që të bëhet ky raportim...Cka kam kërkuar unë, ka qenë fakti që e përmendi edhe Eshrefi: pra, duhet të kishim rekomandime në raport...Pra, duhet të jemi më konkret, meqenëse, kemi aktivitete të shumta...Kisha dashur me e ditë se çka do të bëjmë me ato aktivitete që nuk janë realizuar, përkundër gjendjes që e dimë të gjithë në të cilën kemi kaluar...

Çemailj Kurtişi: Ju përshëndes të gjithëve, unë mendoj se raporti mirë është punuar, mirëpo disa specifika nuk janë realizuar për shkak të pandemisë...mirëpo, problem është edhe ajo se, në të shumtën e rasteve po kemi zgjedhje të jashtëzakonshme, dhe ky është një problem më vete...

Pajtohem që duhet kushtuar shumë vëmendje Listave Votuese, korrigjimit të tyre, por edhe duhet të fokusohemi te Votimi me Postë sepse, po kemi probleme...Kurse, te punësimi: nuk kemi asnjë boshnjak të punësuar, dhe besoj që edhe kësaj do t'i kushtoni vëmendje...pra, kjo të merret parasysh...

Alim Rama: Te ajo që tha Eshrefi ! KOZ, i ka dhënë këshilla Sekretariatit, por raporti e pasqyron planin e punës...dhe ne, nuk mund të kërkojmë diçka që s'është në plan të punës...

Në këtë pikë, diskutuan më tej edhe: Valdete Daka, Yll Buleshkaj.

Valdete Daka: Kush është për miratimin e këtij raporti ?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këtë raport.

3.Këshilli për Cështje Ligjore:

1.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Suharekë.

Arianit Elshani: Këshilli, ka shqyrtuar ka shqyrtuar kërkesën për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal në Suharekë, dhe rekomandon tutje në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit.

Valdete Daka: Kush është për që, znj, Bardha Gashi të emërohet anëtare e kuvendit komunal në Suharekë nga subjekti politik AAK, duke e zëvendësuar anëtares e deritashme, Besa Kuqi.

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këtë rekomandim

2.Shqyrtim i kërkesave për shtyrje të Kuvendeve të Partive Politike: Organizata e Ballit Kombëtar të Kosovës, Balli Kombëtar i Kosovës, Gradanska Iniciativa Gore, Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës dhe NISMA Socialdemokrate

Arianit Elshani: Këshilli, ka pranuar një rekomandim nga ZRPP lidhur me shtyrjen e kuvendeve të partive politike, dhe pasi që ne kemi bërë shqyrtimin, janë marrë nga Sekretariati të gjitha rrethanat, ne rekomandojmë edhe më tutje që të aprovet kjo kërkesë e tyre.

Valdete Daka: Atëherë, e kemi kërkesën e Organizata e Ballit Kombëtar të Kosovës, Balli Kombëtar i Kosovës, që të shtyhet mbajtja e kuvendit të tyre deri më 26 qershor, 2020, e kemi kërkesën e NISMA Socialdemokrate që ka kërkuar shtyrje deri më 26 dhjetor, 2020. PSHDK, deri më 31 korrik, 2020, dhe Gradanska Iniciativa Gore, deri më 20 qershor, 2020, dhe Balli Kombëtar i Kosovës, deri më 22 dhjetor, 2020

Pra, kush është për këto rekomandime ?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këtë rekomandim

Sami Kurteshi: Ne, e diskutuam që, janë dy data shumë afër, në qershor...! Pra, për shkak të rrethanave që nuk varen prej tyre, të kihet parasysh që t'u jepet prapë mundësi shtyrje, nëse kërkohet...

Arianit Elshani: Ata, vetë i kanë caktuar këto data...!

Anëtarët e KQZ-së, me 10 vota për dhe 1 kundër, miratuan këtë rekomandim

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të rishikuar të auditimit të brendshëm për vitin 2020

Yll Buleshkaj: Për shkak të gjendjes dhe kërkesave shtesë që ka marrë auditori, është paraqitur kërkesa që të rishikohet plani i auditimit... ! E keni planin...

Sulejman Gashi: Standardet e auditimit, parashohim që në kushtet e rreziqeve kur ndryshohen prioritet, ose rrethana tjera, duhet të rishikohet plani. Në rastin tonë, te ne nuk ka ndryshuar asgjë, veq afati kohorë për shkak të rrethanave pandemike...Plani është a që ka qenë, veq një detyre më pak...Pra, 3 detyrat e para – aktivitetet e prokurimit për zgjedhjet 2019, me prioritet ka qenë materiali administrativ dhe informimi publik...Kështu, është dashur të kemi raport final, por është shtye dhe besoj me 15 qershor kjo do të finalizohet....dhe një detyrë – me kërkesë të Kryetares, është kryer...raporti është shpërndarë...

Në bazë të detyrave, kanë mbetur 3 detyra të rregullta, por është hequr detyra e fundit që ka pasur të bëj me komunikimi, menaxhimin dhe raportimin...Kurse, deri në fund të vitit do të jetë prokurimi që do të kryhet në qershor, dhe po ashtu do të jetë rekrutimi i stafit jo permanent që ka qenë kërkesë e KQZ për ta bërë auditimin e kësaj fushe...

Krejt çka është ndryshim, është hequr ajo detyra që thash më lartë...

Sami Kurteshi: Në fund të raportit, është një tabelë me ngjyra që kam nevojë ta shpjegoni... Po dua ta shpjegoni çka është rrezik i ulët, i mesëm dhe i lartë...! Dhe e dyta: “..numri i përgjithshëm i ditëve për person...!”

Sylejman Gashi, auditor i brendshëm, u përgjigj gjerësisht lidhur me pyetjet e anëtarit, z. Kurteshi.

Pastaj, në shqyrtim të mëtejshëm në debat lidhur me këtë pikë me analizat dhe sugjerimet e tyre, u angazhuan edhe: Eshref Vishi, Sylejman Gashi, Arianit Elshani.

Në fund të debatit, anëtarët e KQZ-së me vota unanime miratuan Planin vjetor të rishikuar të Auditimit të brendshëm për vitin 2020

5. Të ndryshme

Yll Buleshkaj: si njoftim: të premtën, e kemi pranuar një shkresë nga MEF me udhëzim të rishikimit të buxhetit. Sipas shkresës, rishikimi i buxhetit bëhet me qëllim të identifikimit të kursimeve që t'përdoren për masat që janë shkaktuar nga pandemia. Ne si Sekretariat, jemi takuar dhe, nuk kemi mundur të identifikojmë shkurtrim në buxhet...kemi qenë konservativ mendoj, në buxhet...Ajo që kërkojmë, është të na kthehen dy pozitat që na janë shkurtuar...

Kurse, lidhur me zgjedhjet që do ti kemi në Mitrovicë, jemi duke u marrë me parallogaritë për buxhet shtesë...

Alim Rama: Po flasim për zgjedhjet në Mitrovicë, por po më duket se i kemi harruar zgjedhjet në Podujevë ! Kërkoj që ti bëhet një kërkesë ISHKP-së për rivlerësimin e gjendjes, gati gjitha masat janë hequr...KQZ, duhet me caktuar ditën kur procesi ri starton...e dimë që tre ditët e fushatës janë hequr, pra a ka me pas fushatë apo s'ka me pas...?

Valdete Daka: Kur të vendoset data, i shqyrtojmë edhe këto probleme, sepse ne nuk mund të vendosim për datën...s'jemi ne palë që caktojmë fatin, datën...